



Jetmir Nuka është diplomuar në Universitetin Amerikan në Kosovë dhe ka përfunduar studimet master në Universitetin e Sheffield në Greqi, në fushën e Administrimit të Biznesit.

Ka një përvojë të gjatë në menaxhimin dhe administrimin e biznesit në sektorë të ndryshëm. Gjatë karrierës së tij ka demonstruar aftësi të forta drejtuese dhe strategjike. Nga viti 2008 deri në vitin 2022, ka shërbyer si Drejtor i Departamentit të Administratës së Përgjithshme në Bankën Kombëtare Tregtare në Kosovë. Në

këtë rol, ai ka udhëhequr operacionet bankare, prokurimin, sigurinë dhe administrimin e aseteve, duke sjellë përmirësime të ndjeshme në efikasitetin operativ të institucionit.

Në vitin 2022, ai mori drejtimin e kompanisë “Dux Minerals” LLC, si Menaxher i Përgjithshëm, ku mbikëqyr eksplorimin dhe tregtimin e mallrave në tregjet ndërkombëtare. Paralelisht, gjatë periudhës 2021-2024, ka shërbyer si Anëtar i Komitetit të Auditimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, duke kontribuar në mbikëqyrjen financiare dhe rritjen e transparencës institucionale.

Në janar të vitit 2024, z.Nuka është emëruar Kryesues i Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Hekurudhat e Kosovës – Trainkos Sh.A. Angazhimi dhe përkushtimi në HK-Trainkos është fokusuar në drejtimin strategjik dhe mbikëqyrje të qeverisjes, me synimin për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe efikas të sektorit hekurudhor në Kosovë.

Kontakti:

✉ jetmir.nuka@trainkos.com

✉ jetmirnuka84@gmail.com

☎ 038/534-821; 038/534-837